



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria – Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health

20 Prill 2020
Nr. Xx/2020

Bazuar në nenin 132 të Ligjit Nr. 05/L -031 - Për procedurën e përgjithshme administrative, nenin 38 të Ligjit 04/L-190- Për Produkte dhe Pajisje medicinale, nenin 17 të Udhëzimit Administrativ 02/2019 - Për rregullimin e çmimeve të produkteve dhe pajisjeve medicinale, Vendimin nr. protokolli 35/2019, datë 27.06.2019, me rastin e shqyrtimit të kërkesës me Nr. 50, të datës 31.03.2020, nga Kompania **Smartmed**, me seli në Prishtinë, me adresë: Banesat e Lesnës, hyrja C2, nr.8, me person përgjegjës **Gentian Lila**, të ushtruar kundrejt vendimit të komisionit për çmime të publikuar më 23 Mars në webfaqen e MSH, Komisioni për çmime, në takimin e mbajtur me datë 30.04.2020, nxjerr këtë:

VENDIM

Aprovohet pjesërisht kërkesa për rishqyrtim të çmimeve e parashtruar nga martmed, me seli në Prishtinë, rruga Banesat e Lesnës, hyrja C2, nr.8.

Çmimet finale janë si vijon:

1. Alprazolam Basi, Alprazolam, TABLET, 0.25mg, 60 tab. për të cilin ka aplikuar për çmimin 1.80
2. Alprazolam Basi, Alprazolam, TABLET, 1mg, 60 tab, për të cilin ka aplikuar për çmimin 7.00

Arsyetimi

Ministria e Shëndetësisë, përkatësisht komisioni për çmime bazuar në dispozitat e Udhëzimit Administrativ 02/2019 për rregullimin e çmimeve të produkteve medicinale pas zhvillimit të procedurave të parapara me aplikacionet, dhe evalumin e tyre më datë 23 Mars 2020 ka publikuar

vendimin për përcaktimin e çmimeve të produkteve medicinale të cilat posedojnë autorizim për marketing pranë AKPPM. Bazuar në paragrafin 1 të nenit 17 kundër vendimit të komisionit pala ka të drejtë të parashtrijë kërkesë për rishqyrtim në komisionin për çmime në afat prej 8 ditësh nga dita e publikimit të vendimeve.

Smartmed, me seli në Prishtinë, rruga Banesat e Lesnës, hyrja C2, nr.8 , bazuar në paragrafin 1 të nenit 17 të UA 02/2019, brenda afatit ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim të çmimeve të produkteve medicinale si vijon

1. Alprazolam Basi, Alprazolam, TABLET, 0.25mg, 60 tab. për të cilin ka aplikuar për çmimin 4.30
2. Alprazolam Basi, Alprazolam, TABLET, 1mg, 60 tab. për të cilin ka aplikuar për çmimin 7.00

Komisioni duke u bazuar në dispozitat e udhëzimit administrativ përkatësisht në paragrafin 2 të nenit 17 të UA 02/2019 ka përcaktuar si vijon:

MAH:LABORATORI BASI-INDUSTRIA FARMACEUTICA S.A,PORTUGAL

Emri i produktit	INN	Forma farmaceutike	Fortesia	Madhesia e paketimit	Çmimi i deklaruar	Çmimi në € në vendet referente/origjinës	Çmimi final në Euro	Komenti nga komisioni
Alprazolam Basi	Alprazolam	TABLET	0.25mg	60 tab.	4.30		1.80	origjinator Xanax
Alprazolam Basi	Alprazolam	TABLET	1mg	60 tab.	7.00		7.00	Në mungesë të çmimeve në shtetet primare , sekondare dhe ne vendin e origjinës, aprovohet çmimi i deklaruar

Nga sa u tha u vendos si në dispozit të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala ka të drejtë ankese 15 ditë kalendarike pas shpalljes së kësaj përgjigjeje në Bordin për Ankesa për çmime të produkteve medicinale në Ministrinë e Shëndetësisë.

Komisioni për çmime:

1. Naim Bardiqi MSH kryetar
2. Selvete Shuleta AKPPM anëtare
3. Etrit Tetova AKK anëtar
4. Amir Keka FSSH anëtar
5. Shkumbin Jusufi OFK anëtar
6. Dardan Nallbani MTI anëtar



7. Blerta Kika MF anëtare

B/14

Vendimi i dërgohet:

Palës,

Departamenti farmaceutik,

Arkivës.